



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D' Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K1/I208-11 Prot.
Nr. Dok. 202500835/11

Tiranë 09/07/2025

Lënda: Rekomandim për rritjen e angazhimit intitucional për të siguruar që politikat publike të adresojnë efektivisht nevojat dhe pritshmëritë e pensionistëve për të garantuar një standard jetese, të qëndrueshëm dhe dinjitoz.

MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

Për dijeni:

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të shtetasve, nga veprimet ose mosveprimet e organeve të administratës publike, duke marrë shkas nga protesta e të moshuarve pra Kryeministrit e cila është pasqyruar ne mediat online dhe konkretisht "Dosja.al"¹ ka ndërrmarë për shqyrtim rastin me inisiativë, në përputhje me

¹ <https://dosja.al/tag/pensionistet-proteste-paa-kryeministrise>
<https://dosja.al/aktualitet/te-genjyer-nga-qeveria-te-braktisur-nga-media-pensionistet-proteste-p-i401265>

nenin 13/3, të ligjit Nr 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Në artikullin e publikuar theksohet fakti se pensionistët vijnë protestat e tyre dhe vijnë me thirrjet ku kërkojnë rritje të pensioneve. Sipas tyre pensionet e tyre jo vetëm nuk u rritën, por u indeksuan me vonesë dhe jo në përputhje me rritjen galopante të çmimeve.

"Të gënjer nga qeveria, të braktisur nga media! Mjaft me tallje, rrisni pensionet. Deputetët 100% rritje page, pensionistët 4.1%. Kërkojmë rritje pensioni", janë disa nga mesazhet e tyre.

Pas regjistrimit të kësaj çështjeje, Institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar se ky rast plotëson të gjithë kushtet thelbësore si në aspektin formal, ashtu edhe në atë substancial për t'u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj bazuar në nenin 13, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar (ligji nr. 8454/1999), ka vendosur ta pranojë atë dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes. Në zbatim të detyrimit kushtetues e ligjor dhe konkretisht, të paragrafit 4, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: “Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”, si dhe nenit 19, shkronja “b”, të ligjit nr. 8454/1999, ku parashikohet se: “Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”, në vijim të hetimit administrativ me qëllim sqarimin e fakteve e të rrethanave, i jemi drejtuar me shkresa për informacion dhe shpjegime, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit², Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, lidhur me *planin dhe masat që parashikohen të merren lidhur me problematikën e masës së ulët të pensioneve dhe angazhimin institucional të tyre për adresimin e kësaj problematike..*

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka adresuar kërkesën e Avokatit të Popullit për trajtim dhe kompetencë³ në Drejtorinë e Politikave të Sigurimeve Shoqërore, me porosi ndaj drejtuesit të Ekipit të Programit

² Shkresa nr. K1/I208-2 Prot., datë 07.11.2024 “Kërkesë për shpjegime”; Shkresa nr. K1/I208-6 Prot., datë 20.12.2024 “Kërkesë e përsëritur për shpjegime”.

³ MEKI, Shkresa nr. 14271 Prot., datë 21.11.2024 “Për trajtim, Drejtorisë së Politikave të Sigurimeve Shoqërore”

Buxhetor për Sigurimet Shoqërore duke kërkuar trajtimin e saj sipas legjislacionit në fuqi.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka adresuar kërkesën e Avokatit të Popullit për trajtim dhe kompetencë⁴, Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe për dijeni të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Në mungesë të përgjigjes, institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore me kërkesa të përsëritura për informacion dhe shpjegime.⁵

Instituti i Sigurimeve Shoqërore në përgjigje të kërkesave të institucionit Avokatit të Popullit informon se:

Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH) është institucioni përgjegjës për zbatimin e ligjit nr. 7703/1993, i cili rregullon sistemin e sigurimeve shoqërore në Shqipëri. Ky ligj vendosi një skemë të detyrueshme publike, e cila funksionon mbi bazën e parimit kontributiv "Paguaj sot, që të përfitosh nesër". Kjo skemë ofron mbrojtje sociale për kontribuesit në raste si sëmundja, invaliditeti, pleqëria, aksidentet në punë dhe humbja e mbajtësit të familjes, duke siguruar një lidhje të drejtë mes kontributit dhe përfitimeve të marra.

Gjatë viteve, skema e sigurimeve shoqërore është reformuar dhe përmirësuar, duke marrë parasysh raportin midis kontribuesve dhe përfituesve. Pensionet dhe trajtimet financiare të lidhura me këtë skemë janë indeksuar rregullisht për të kompensuar ndryshimet e çmimeve dhe për të ruajtur fuqinë blerëse të pensionistëve. Këshilli i Ministrave përcakton metodën dhe datën e indeksimit të këtyre përfitimeve, duke administruar edhe skemat suplementare dhe trajtimet e veçanta financiare që menaxhohen nga ISSH.

ISSH ka si mision jo vetëm zbatimin e ligjit, por edhe sigurimin e shërbimeve efektive dhe pa kosto shtesë për përfituesit, sipas kontributit të tyre. Megjithatë, ky institucion nuk ka kompetencë për të ndryshuar apo propozuar rritje të pensioneve apo ndryshime në ligjin ekzistues. Çdo iniciativë për reformimin e skemës bëhet në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, duke ofruar

⁴ MSHMS, Shkresa nr. 4645/1, datë 27.11.2024 "Përcillet shkresa për kompetencë"

⁵ Shkresa nr. K1/I208-7 Prot., datë 20.12.2024 "Kërkesë për shpjegime"; Shkresa nr. K1/I208-8 Prot. datë 23.01.2025 "Kërkesë e përsëritur për shpjegime"

ekspertizën e nevojshme në hartimin dhe vlerësimin e politikave të sigurimeve shoqërore.

Në vijim, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me shkresën nr. K1/I208-10, datë 25.02.2025 informon se:

Në përgjigje të shkresës tuaj, protokolluar në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me nr. 16265 prot., datë 26.12.2024, ku kërkonte informacion në lidhje me masën e pensioneve, ju informojmë se:

Sistemi i përgjithshëm i sigurimeve shoqërore mbështetet në parimin kontributiv, parimin e vetëpërgjegjësisë së individit për risqet e së ardhmes në fushën sociale, si dhe në parimin e marrëveshjes së brezave "paguaj sot që të përfitosh nesër (pay as you go)".

Indeksi i pensioneve është një nismë e ligjvënës, i cili nëpërmjet nenit 61, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, në të cilin përcaktohet se: pensioni social, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit, familjare si edhe të ardhurat nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale indeksohen çdo vit, për të kompensuar pasojat e ndryshimit të çmimeve të mallrave dhe të shërbimeve të zgjedhura për nivelin minimal të jetesës së pensionistëve.

Qeveria Shqiptare ka adresuar disa nga sfidat në sistemin e pensioneve me masa, të cilat janë krijuar për të ruajtur parimin kontributiv, për të garantuar drejtësi dhe për të ruajtur neutralitetin brenda sistemit të sigurimeve shoqërore. Në vitin 2024 dhe në fillim të vitit 2025, qeveria prezantoi mbështetje financiare përmes bonuseve për të përmirësuar mjaftueshmërinë e pensioneve dhe për të zvogëluar hendekun midis pensioneve më të ulëta dhe më të larta.

Bonusi i fundvitit, me vendimin nr. 736, datë 27.11.2024 "Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fundvitit 2024", u strukturua në dy fasha si vijon: pensionistët me pensione mujore deri në 20 000 lekë përfituan një bonus prej 15000 lekë, ndërsa ata me pensione mbi 20 000 lekë në muaj, përfituan një bonus prej 10 000 lekësh. Gjithashtu, për shkak të performancës së mirë ekonomike në vitin 2024, me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 20, datë 9.1.2025, "Për mbështetjen financiare të pensionistëve për vitin 2025", u mundësua mbështetje financiare sipas dy fashave të mëposhtme: 10 000 lekë për pensionistët me pension bazë deri në 20 000 lekë në muaj dhe 5 000 lekë për pensionistët me pension bazë mbi 20 000 lekë në muaj.

Varfëria mes të moshuarve është një çështje globale. Duke iu përgjigjur problematikës së varfërisë së të moshuarve, disa organizata të OKB-së, të

udhëhequra nga ILO⁶, kanë zhvilluar një kornizë të hartimit të politikave të referuara si “dysHEMEJA e mbrojtjes sociale”⁷ që lidhet me drejtën e secilit për siguri sociale dhe të drejtën për një standard jetese të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tyre dhe familjeve të tyre”.

Deklarata Politike dhe Plani Ndërkombëtar i Veprimit i Madridit për Plakjen, i referuar përgjithësisht si "Plani i Madridit"⁸, bën thirrje për zhdukjen e varfërisë tek të moshuarit dhe sigurinë sociale të të ardhurave, duke i kushtuar vëmendje të veçantë grupeve të pafavorizuara social/ekonomike. Në këtë dokument përshkruhen dhe hapat e nevojshëm për të siguruar të ardhura minimale të mjaftueshme për të gjithë personat e moshuar, veçanërisht anëtarëve të grupeve të pafavorizuara shoqërore dhe ekonomike. Gjithashtu ai bën thirrje për krijimin, aty ku është e përshtatshme, një sistemi pensioni dhe përfitimi paaftësie pa kontribut; *organizimi i sistemeve të mbrojtjes sociale/sigurimeve shoqërore për të siguruar të ardhura minimale për personat e moshuar pa mjete të tjera mbështetjeje, veçanërisht gratë që jetojnë vetëm dhe prirjen të jenë më të cenueshme nga varfëria; dhe duke marrë parasysh standardet e jetesës së të moshuarve sa herë që reformohen sistemet e pensioneve dhe sigurimi i aftësisë së kufizuar, sipas rastit.*

Mbrojtja sociale është jetike gjithashtu për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së (SDG), duke përfshirë një numër të SDG-ve që kanë të bëjnë me çrrënjosjen e varfërisë, shëndet të mirë, barazi gjinore, rritje ekonomike dhe punë të denjë, reduktim të pabarazive, qytete të qëndrueshme⁹ dhe institucione efektive dhe të përgjegjshme.

Sipas të dhënave të publikuara nga Eurostat, për vitin 2022, shpenzimet për pensione në Bashkimin Evropian përbëjnë mesatarisht 12.2% të PBB-së, ndërsa për vitin 2023, përfitimet për pleqëri (old-age) arrijnë 10.4% të PBB-së, brenda një kategorie më të gjerë të mbrojtjes sociale që përfshin 19.2% të PBB-së.¹⁰

⁶ Organizata Ndërkombëtare e Punës.

⁷ Social Protection Floor; https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---ilo-brussels/documents/genericdocument/wcms_169305.pdf

⁸ Miratuar në Asamblenë e Dytë Botërore mbi Plakjen e mbajtur në Madrid në vitin 2002, <https://www.un.org/esa/socdev/documents/ageing/MIPAA/political-declaration-en.pdf> ;

⁹ Objektivi 1: Fundi i varfërisë në të gjitha format e saj kudo – për të gjithë burrat dhe gratë.

Objektivi 2: T'i jepet fund urisë, të arrihet siguria ushqimore dhe të ushqyerit e përmirësuar dhe të promovohet bujqësia e qëndrueshme duke përfshirë edhe për të moshuarit.

Objektivi 3: Sigurimi i një jete të shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat nëpërmjet mbulimit shëndetësor universal, duke përfshirë mbrojtjen nga rreziku financiar.

Objektivi 16: Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.

¹⁰ Eurostat 2022 – Pension Expenditure: https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Social_protection_statistics_-_pension_expenditure_and_pension_beneficiaries

Eurostat 2023 – Social Protection Expenditure: https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Government_expenditure_on_social_protection ;

Nga të dhënat zyrtare¹¹ në Shqipëri, rezulton se shpenzimet për pensione përbëjnë 7.4% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB-së) dhe 25.3% të totalit të buxhetit vjetor të shtetit. Krahasimisht, të dhënat tregojnë se vendet e eurozonës kanë një orientim më të fortë buxhetor drejt mbështetjes së popullsisë në moshë pensioni, me një investim publik që kalon 10 euro për çdo 100 euro të PBB-së, krahasuar me vetëm 7.4 euro në Shqipëri. Gjithashtu, në raport me popullsinë në plakje dhe presionin që i ushtrohet skemës publike të pensioneve, kjo përqindje konsiderohet e ulët për garantimin e standardeve minimale të jetesës për pensionistët.

Në vijim, në vlerësim të peshës që zënë shpenzimet mesatare mujore për grupet kryesore të konsumit, sipas Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (2023) për Njësi Ekonomike Familjare (NJEF)¹², tregohet qartasi se pensionistët përballen me sfida të mëdha në menaxhimin e financave personale¹³. Këto kushte i vendosin ata në vështirësi për të ruajtur një standard jetese të përshtatshëm.

Plani Kombëtar i Moshimit 2020-2024 në Shqipëri, parasheh se problemi më kritik i moshës së tretë është varfëria ekonomike, e shkaktuar nga mungesa ose pamjaftueshmëria e të ardhurave. Dhjetë vite pas reformës së pensioneve vërehet se sistemi përballlet me sfida të lidhura me demografinë dhe ekonominë. Referuar të dhënave statistikore në këtë dokument, vërehet se raporti i vartësisë së moshimit pothuaj dyfishohet, nga 8.6 % në vitin 1989 në 16.7 % në vitin 2011. Në vitin 2030, ky raport pritet të dyfishohet sërish, për të arritur në nivelin 32.9 %.

Rrjedhimisht, për sa theksuam më lart, masa e ulët e pensioneve është një çështje e rëndësishme për pensionistët. Rritja e pensioneve është e nevojshme për të siguruar një jetesë me dinjitet për ta.

Për këtë arsye, në kontekstin e shqetësimeve të vazhdueshme mbi mirëqenien e pensionistëve, të cilat janë adresuar në mënyrë të vazhdueshme nga institucioni i Avokatit të Popullit, është thelbësore që politikat publike të adoptojnë një qasje më të gjerë dhe gjithëpërfshirëse për të adresuar në mënyrë efektive nevojat dhe pritshmëritë e kësaj kategorie qytetarësh. Për të garantuar një standard jetese të qëndrueshëm dhe dinjitoz për ta, është thelbësore që institucionet përgjegjëse të ndërmarrin veprime konkrete dhe të

¹¹ <https://financa.gov.al/newsroom/miratohet-nen-per-nen-dhe-ne-teresi-projektbuxheti-dhe-paketa-fiskale-e-vitit-2024/>; <https://arkiva.financa.gov.al/wp-content/uploads/2023/11/Buxheti-për-Qytetarët-Ministria-e-Financave-dhe-Ekonomisë.pdf>

¹² Në vitin 2023, shpenzimet mesatare mujore për konsum për një Njësi Ekonomike Familjare, e përbërë mesatarisht nga 3,7 persona, vlerësohen me 91.675 lekë. Ky tregues është 3,7 % më i lartë se në vitin 2022. <https://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-buxhetit-t%C3%AB-nj%C3%ABsive-ekonomike-familjare/publikimet/2024/anketa-e-buxhetit-t%C3%AB-nj%C3%ABsive-ekonomike-familjare-2023/>

¹³ <https://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-t%C3%AB-ardhurave-dhe-nivelit-t%C3%AB-jetes%C3%ABs-aan/publikimet/2024/matja-e-t%C3%AB-ardhurave-dhe-nivelit-t%C3%AB-jetes%C3%ABs-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-2023/>

mirëstrukturuara, duke e trajtuar këtë çështje si një prioritet social dhe ekonomik.

Avokati i Popullit si institucion i pavarur, i parashikuar shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, shërben si garanci kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, në përmbushje të misionit kushtetues, si garant i mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe nxitës i standardeve më të larta të këtyre të drejtave, i kushton një vëmendje të posaçme dhe ndjek e trajton me prioritet mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të grupeve në nevojë.

Në lidhje me rastin objekt shqyrtimi, referuar përgjigjeve të administruara, Avokati i Popullit vlerëson përpjekjet e *Qeverisë Shqiptare e cila ka adresuar disa nga sfidat në sistemin e pensioneve me masa, të cilat janë krijuar për të ruajtur parimin kontributiv, për të garantuar drejtësi dhe për të ruajtur neutralitetin brenda sistemit të sigurimeve shoqërore, si dhe mbështetjen financiare përmes bonuseve për të përmirësuar mjaftueshmërinë e pensioneve dhe për të zvogëluar hendekun midis pensioneve më të ulëta dhe më të larta përgjatë vitit 2024 dhe në fillim të vitit 2025.*

Megjithatë duke qenë se problematika e masës së ulët të pensioneve vazhdon të raportohet nga qytetarët, Avokati i Popullit vlerëson se është e nevojshme marrja e masave të mëtejshme për një vlerësim të drejtë, thelbësor të kësaj problematike dhe përpjekjet për adresimin deri në zgjidhjen e saj duhet të jenë ndërshtetërore, të jenë intensive dhe të vazhdueshme, pasi problemi është strukturor dhe sistemik.

Gjithashtu theksojmë se marrja e këtyre masave efektive shkon në të njëjtën linjë me përmbushjen e kriterëve politike që Bashkimi Europian ka vendosur ndaj vendit tonë, si kusht për procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Konkretisht, një nga këto kushte ka të bëjë me, përmirësimin e të drejtave të njeriut dhe të kushteve social-ekonomike, ku përfshihen si subjekte edhe të moshuarit.

Në përfundim, Avokati i Popullit në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin sanksionohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata Publike”*, dhe nenet 21, 22 e 22/1 të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar;

REKOMANDON:

- *Rritjen e angazhimit intitucional me veprime konkrete dhe të mirëstrukturuara për të siguruar që politikat publike të adresojnë në*

mënyrë efektive nevojat dhe pritshmëritë e pensionistëve për të garantuar një standard jetese të qëndrueshëm dhe dinjitoz, duke hartuar një plan masash të qëndrueshme ekonomike, të cilat e trajtojnë mirëqenien e pensionistëve si një prioritet strategjik dhe të pandashëm nga zhvillimi i përgjithshëm i vendit.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, plotësuar me Ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin nr.9398 datë 12.05.2005, ku përcaktohet se: *“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”*, lutemi, pas shqyrtimit, të na vini në dijeni për qëndrimin ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R E

Vilma SHURDHA

DV